



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 972/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Gjakovë, paraqitur kundër Aleancës për Ardhmërin e Kosovës (AAK), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor të raundit të dytë gjatë zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Aleancës Kosova e Re (AKR), dega në Gjakovë.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 01.12.2013, në Komunën e Gjakovës, shihen nëpër profile të anëtarëve të AAK-së publikime të videoeve gjatë procedurës së votimit të tyre siç kemi rastin e Remzi Kokalla, Nikoll Rrasi të cilët kanë postuar videot në profilet e tyre në facebook, që është në kundërshtim me ligjin, inçizimi i votës.  
Në cilësinë e provës ankesa ka të bashkangjitur disa fotografi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apelohe vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikojë cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Pretendimet ankimore se anëtarët e AAK-së përkatësisht Remzi Kokalla, Nikoll Rrasi kanë postuar në profilet e tyre në facebook publikime të videoeve gjatë procedurës së votimit, nuk qëndrojnë sepse fotografit e ofruara nuk janë dëshmi bindëse dhe të mjaftueshme për të vërtetuar se nga kush janë postuar, me këtë rast vihet në dyshim se

është kryer një veprim i ndaluar dhe nuk mund të vërtetohet shkelja e supozuar. Andaj , PZAP-i konstaton se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartëpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 972/2013 më datën 04.12.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**



***Këshillë Juridik:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 ( njëzetekatër )orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.